



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201701690/16

Tiranë ___/___/2018

Lënda : Rekomandim "Për marrjen e masave me qëllim zbatimin korrekt nga Policia e Shtetit, e dispozitave ligjore për zhvillimin normal të tubimeve paqësore të qytetarëve dhe për rastet e shpalljes në kërkim të personave, në respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".

Drejtuar : Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit
Z.Ardi VELIU
Drejtues Madhor

TIRANË

I nderuar Z.Drejtor,

Avokati i Popullit mbi bazën e disa shkrimeve të bëra publike në media, ka filluar me inisiativë rastin e protestës së datës 18 Dhjetor 2017, organizuar nga subjektet politike opizitare, tek sheshi para Parlamentit.

Ndërkohë që nga mediat janë raportuar episode sporadike përplasjesh fizike midis qytetarëve dhe forcave të Policisë së Shtetit, dhe pas përfundimit të protestës, ndalimin e disa protestuesve si persona të shpallur në kërkim policor, në vëndkalimet kuiftare me Republikën e Shqipërisë.

Mbi këtë shqetësim qytetar, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, i cili ka konsistuar në mbledhjen e informacionit shkresërisht për të verifikuar nëse ka tejkalim të kompetencave nga ana e efektivëve të Policisë së Shtetit, dhunë të pajustificuar të ushtruar mbi protestuesit, apo veprime të tjera që çenojnë të

drejtën themelore të qytetarëve për të tubuar dhe protestuar normalisht në një vënd demokratik.

Nga ana tjetër janë kryer verifikime në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është kërkuar informacion Drejtorisë Vendore të Policisë, kurse nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit pas kërkesës tonë, na është vënë në dispozicion Udhëzimi i Ministrisë të Brëndshëm Nr.56/1 datë 27.05.2013, *“Për Përdorimin e burimeve të informacionit, marrjen, administrimin, verifikimin dhe vlerësimin e të dhënave”*.

Janë marrë deklarime disa qytetarëve pjesëmarrës në protestën e 18 Dhjetorit 2017, si z.B. M., z. E. M., dhe z.H. V., janë administruar shkrime nga media të ndryshme për zhvillimin e protestës, ashtu dhe raste të ndalimit të qytetarëve gjatë kalimit në vendkalimet kufitare të Republikës së Shqipërisë, si persona të shpallur në kërkim policor.

Në shpjegimet e tyre qytetarët kanë deklaruar se, gjatë zhvillimit të protestës kanë qënë korrektë në sjellje dhe veprime brënda etikës, duke mos fyer apo bërë thirrje për të nxitur turmën për të kryer veprime të dhunshme ndaj policisë. Veç sa sipër, gjatë zhvillimit të protestës, ata kanë vërejtur persona civilë që fotografonin nga afër pjesëmarrësit në protestë.

Deklaruesit kanë shpjeguar se pas përfundimit të protestës kanë shkuar në banesat e tyre në orët e vona të natës, rreth orës 22.00-23.00, ku janë vënë në dijeni nga familjarët se kishin ardhur efektivë të policisë me disa furgona, të cilët kanë kërkuar paraqitjen në Polici.

Kështu ka ndodhur me shtetasin H. V., i cili me marrjen dijeni, më datë 19 Dhjetor 2017, ora 10.00 është paraqitur në Komisaratin e Policisë nr.2, por është pyetur nga Policia Gjyqësore e Drejtorisë së Policisë Tiranë vetëm pas 3 orëve. Kurse shtetasi E. M., pasi ka marrë fletë thirrjen nga Policia më datë 07.01.2018, ka shkuar në Policinë Gjyqësore dhe ka dhënë deklaratimet e nevojshme. Sa i përket shtetasit B. M., (person i cili paraqitet me henediskale), ai më datë 25 Dhjetor 2017, bashkë me familjen, me mjetin që ka në pronësi është nisur në Tropojë, ku në vendkalimin kufitar të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Kosovës, është njoftuar prej punonjësve të policisë se ishte shpallur në kërkim për protestën. Pasi është kthyer nga Tropoja, më datë 27 Dhjetor 2017, ka vënë në dijeni strukturat qendrore të Partisë Demokratike dhe pas kësaj ka shkuar në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, ku dhe ka dhënë deklaratimet. Në të njëjtën mënyrë nga Policia e Shtetit është vepruar në vendkalimet kufitare edhe ndaj shtetasve z. O. L., e znj.mF. N., të cilët janë pyetur në cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethana të hetimit, si pjesëmarrës në protestën e datës 18 Dhjetor 2017.

Për asnjë nga personat e shpallur në kërkim policor, pjesëmarrës në protesë, nga organi i Prokurorisë së Rrrethit Gjyqësor Tiranë, nuk është ngritur akuzë konkrete në proçdimitin penal nr.10213/2017.

Personat e pyetur nga ana e jonë, kanë shpjeguar se pas protestës, për asnjë rast nuk kanë lëvizur nga vëndbanimet e tyre, veçse kanë zhvilluar normalisht aktivitetin e tyre privat. Konstatohet gjithashtu se ata janë drejtues të forumeve rinore, apo kryetar grup seksioni të forcës politike, Partia Demokratike.

Në përgjigjet respektive të datave 05.01.2018 dhe 10.01.2018, dërguar me shkresat nr.380 dhe nr.358/1, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, ka sqaruar se më datë 17 Dhjetor 2017,

ka përpiluar një Plan-Masash “Për zbatimin e masave në garantimin e rendit dhe sigurisë publike, para, gjatë dhe pas zhvillimit të protestës të Partisë Demokratike, më datë 18 Dhjetor 2017, nga ora 0.9.00 -13.00, para Parlamentit në Tiranë”, duke iu referuar dhe bazës ligjore.

Sipas saj, nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit të angazhuar me detyra për mbarëvajtjen e këtij tubimi janë marrë të gjitha masat dhe janë zbatuar me korrektësi të gjitha kërkesat e nenit 133 “a” të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Nga situata e krijuar dhe veprimet e dhunshme gjatë zhvillimit të tubimit si pasojë e kundërshtimit me dhunë, goditjes me sende të forta, nga ana e tubuesve kanë mbetur të lënduar 6 punonjës policie, janë dëmtuar katër kamera të punonjësve të policisë. Janë arrestuar 6 shtetas për veprat penale “Kundërshtimi i punonjësve të policisë”. Po ashtu, për kundërshtim të punonjësve të gardës janë lënë në gjendje të lirë 8 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Nuk ka dijeni për rastin e ndodhur deputetes së forcës politike të LSI, znj. F. K.

Ka një sërë ligjesh dhe akte ndërkombëtare të cilat parashikojnë të drejtën e ushtrimit të tubimeve paqësore të shtetasve.

Kështu, në nenin 1 të Ligjit nr.8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”, thuhet: “Në Republikën e Shqipërisë çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë”

Liria e tubimeve paqësore si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar në nenin 47 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

Kurse në nenin 11 të ligjit nr.8137 datë 31.7.1996 “Për ratifikimin e Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, thuhet: 1.Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët...2.ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t’u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve..”

Në nenin 38 të Kushtetutës thuhet: “Kuzhdo ka të drejtë të zgjedhë vëndbanimin si dhe të lëvizë lirisht në çdo pjesë të territorit të shtetit”.

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur kushtetues, veprimet e Policisë së Shtetit gjatë dhe pas protestës së datës 18 Dhjetor 2017, i trajton dhe vlerëson në një këndvështrim më të gjërë, në kuadër të mbrojtjes të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve. Për këtë, duke analizuar në tërësi veprimet e Policisë së Shtetit në protestën e datës 18 Dhjetor 2017, arrijmë në disa përfundime:

Së pari: E drejta për t’u tubuar të lirë dhe për të protestuar në përputhje me ligjin është një e drejtë kushtetuese për qytetarët shqiptarë, si dhe një e drejtë themelore e njeriut.

Në këtë kontekst do të sugjerohet që në Planin e Masave, Drejtoritë Vendore të Policisë të parashikojnë një trajtim të kujdesshëm të personelit të shërbimit që gjatë instruksionit t’ju shpjegohet për këto raste, duke i sqaruar dhe ndërgjegjësuar se pjesëmarrja e qytetarëve në protestë është e lirë. Për rrjedhojë ushtrimi i së drejtës së tubimit duhet të bëhet në mënyrë korrekte dhe ligjore.

Së dyti: Dokumentimi fotografik nga ana e Policisë së Shtetit për elementë që mund të shkaktojnë shkelje të rendit e sigurisë, apo forma të tjera shkeljesh ligjore, është ligjore

dhe një praktikë normale dhe e kuptueshme e punës së institucionit ligjzbatues të Policisë së Shtetit.

Mirëpo, nga ana tjetër autoritetet duhet të tregohen të kujdesshme për të përdorur dokumentet vizive të siguruara përmes fotografimit, apo filmimit vetëm për qëllimin që ligji u lejon këtë të drejtë.

Kryerja e fotografimeve apo filmimeve në mënyrë të dukshme të gjithë protestuesve nga punonjës policie me uniformë, apo në raste të tjera dhe bërja e fotografive nga persona civilë për identifikimin e protestuesve, duhet të sjellë domosdoshëmrisht marrjen e masave për kufizimin e intimidimit të protestuesve.

Së treti: Ka veprime të parregullta për shpalljen në kërkim policor të shtetasve pjesëmarrës në protestë.

Nga verifikimet e kryera rezultoi se Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, kishte shpallur në kërkim, disa shtetas pjesëmarrës në protestën e datës 18.12. 2017, dhe konkretisht, z.B. M., z.E. M., z.O. L., z.F. H., dhe zj.F. E.

Referuar kërkesave të parashikuara nga neni 2 i Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, për asnjë nga këta shtetas organet e drejtësisë nuk kishin lëshuar urdhër ndalimi si dhe çdo urdhër tjetër të bazuar në ligj dhe ajo që është më e rëndësishme, ata pas protestës për asnjë çast nuk janë larguar nga vëndbanimet e tyre, duke zhvilluar në mënyrë krejt normale aktivitetin e tyre privat.

Policia e Shtetit, për shpalljen në kërkim të personave, është bazuar në nenin 2.8 të Udhëzimit të mësipërm, ku thuhet: *“Persona në kërkim konsiderohen ata persona për të cilët policia dhe strukturat e ngarkuara me ligj kanë të dhëna/informacione se kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale”*.

Duke studjuar dhe analizuar këtë paragraf të nenit 2 të Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm, kemi arritur në përfundimin se ai le shteg për abuzime dhe arbitraritet, dhe si i tillë është i kundërligjshëm pasi bie ndesh me nenin 38 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe ligjin funksional të Policisë së Shtetit nr.108/2014. Konstatohet se paragrafët e tjerë të nenit 2 janë gjetje korrekte për personat e shpallur në kërkim. Për rrjedhojë i kemi kërkuar Ministrit të Brëndshëm shfuqizimin e paragrafit 8 dhe përmirësime në paragrafin 7 të nenit 2 të Udhëzimit.

Së katërti: Nuk ka zbatim korrekt të dispozitave procedurale për thirrjen dhe njoftimin e shtetasve për t’u paraqitur në Policinë Gjyqësore të Policisë së Shtetit.

Kështu rezultoi se më datë 18 Dhjetor 2017, në banesën e shtetasit H. V., në orët e vona të natës rreth orës 23.00, kanë shkuar një numër madh i punonjësve të policisë me dy furgona, dhe meqënëse nuk e kanë gjetur në banesë, iu kanë thënë prindërve për paraqitjen e tij të nesërmen në Komisaratin e Policisë nr.2 Tiranë.

Pasi është vënë në dijeni nga familjarët shtetasi H. V., është paraqitur në atë Komisariat në orën 10.00 por vetëm pas 2 orëve është çuar në Drejtorinë Vendore, ku është kthyer përsëri dhe pasi ka qëndruar dhe 1 orë në ato mjedise, është marrë në pyetje nga Policia Gjyqësore, duke sjellë sorollatje të panevojshme.

Nga Policia Gjyqësore nuk janë zbatuar kërkesat për thirrjen dhe njoftimin për paraqitje në polici të shtetasve të sipërpërmëndur të shpallur në kërkim policor, çka bie ndesh me nenet 133 dhe 134 të Kodit të Procedurës Penale.

Do të sugjeronim që rekomandimi të bëhet objekt i një analize në strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë, duke dalë me detyra konkrete për t'u zbatuar në rastet e tubimeve paqësore të shtetasve.

Sa sipër duke gjetur se veprimet e punonjësve të Drejtorisë vendore të Policisë Tiranë, përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut, ndaj pjesëmarrësve në protestën e datës 18 Dhjetor 2017, në bazë të nenit 21 gërma "c" të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit" i ndryshuar ku thuhet: *"Pas përfundimit të hetimit Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vënd të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen"*,

REKOMANDOJMË

"Marrjen e masave me qëllim zbatimin korrekt nga Policia e Shtetit, të dispozitave ligjore për zhvillimin normal të tubimeve paqësore të qytetarëve dhe për rastet e shpalljes në kërkim të personave, në respektimin e mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut".

Për shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe qëndrimin që do të mbani ndaj tij, të vihemi në dijeni brënda afatit ligjor prej 30 ditësh, konform nenit 22 të ligjit "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Bshkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të dokumenteve të mëposhtme:

- 1.Proçes verbal i marrjes së deklarimeve të ankuesit H. V., datë 21.12.2017.
- 2.Proçes verbal i marrjes së deklarimeve të ankuesit B. M., datë 30.01.2018.
- 3.Proçes verbal i marrjes së deklarimeve të ankuesit E. M., datë 31.01.2018.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA